



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 370/01-14270/24
Kaçanik, 28.06.2024

Në bazë të nenit 11, 12.2 (d) lidhur me nenin 17(g) të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 90 pika 1 dhe 3 e Ligjit Nr.04/L027- për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të Tjera (Gazeta Zyrtare Nr. 22/19 Tetor 2011), të nenit 12 pika 1 paragrafi 6 dhe nenit 31 pika 1 paragrafi 1.1 e Rregullores (QRK) Nr.17/2015 -për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të Tjera (publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me 30.12.2015), të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 370/01-14270/24/ të datës 18.06.2024 përmes Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen me 28 qershor 2024, mori këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR NR.08-320/01-11894/24 TË KOMISIONIT KOMUNAL PËR VLERËSIMIN E DËMEVE NGA RESHJET BRESHËRI NË FUSHËN E BUJQËSISË NË KOMUNËN E KAÇANIKUT NË FSHATIN LLANISHTË DHE KOTLINË

- 1.Me këtë Vendim, Miratohet Raporti Përfundimtar Nr.08-320/01-11894/24 i datës 29.05.2024 i hartuar nga Komisioni Komunal mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e breshëri të datës 21.05.2024 në territorin e Komunës së Kaçanikut-në fshatin Llanishtë dhe Kotlinë, në vlerë prej 8,145.04 €
2. Raporti përfundimtar përmban një vlerësim profesional nga të dhënat evidentuara dhe të regjistruara nga dalja në vend-shikim të komisionit komunal të emëruar nga Kryetari i Komunës dhe kërkesës për kompensim të dëmeve nga (familjet) e dëmtuar nga të reshurat e breshrit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Raporti përfundimtar, në afat ligjor prej 15 ditëve nga dita e miratimit i dorëzohet në Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave dhe një kopje të njëjtësuar Komisionit Qendror të themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me Komisionin Komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të reshurat breshëri.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit të tij në ueb faqen e Komunës.
6. Këtij vendimi i bashkëngjitet: Raporti Përfundimtar Nr.08-320/01-11894/24; 08-320/01-12392/24 i datës 29.05.2024 si dhe shkresat tjera përcjellëse.

Vendimi iu dërgohet: Kryetarit të Komunës; Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë (përmes tyre vendimi dërgohet në Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave dhe në Komisionin Qendror të themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës); Arkivit.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli